

Fjala përshëndetëse e z.Miklovan Kopani, Drejtor i Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvendin e Shqipërisë

I nderuar Komisioner z. Dervishi,

E nderuar znj. Ministre,

Të nderuar përfaqësues të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të vendeve pjesëmarrëse në “Takimin e 27-të të Punës të Rasteve të Veçanta”,
Zonja e zotërinj,

Është kënaqësie e veçantë që të jem sot në çeljen e punimeve të këtij aktiviteti ndërkombëtar, që Zyra shqiptare e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizon, lidhur me trajtimin e rasteve praktike të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Vlerësoj zhvillimin e këtij takimi në vendin tonë, një vend i cili po bën përpjekje të gjithanshme për të forcuar shtetin e së drejtës, duke garantuar liritë dhe të drejtat thelbësore kushtetuese të individit. Njëkohësisht, dua t’ju shpreh z. Komisioner, si përfaqësues i Kuvendit të Shqipërisë, vlerësimin e hapave shumë thelbësorë në mbrojtjen e të drejtës personale dhe respektimin e privatësisë, si të drejta themelore kushtetuese, të cilat shpesh herë shfaqen kaq vulnerabël dhe të cënueshme, pasi janë pjesë e përditshme e jona dhe veprimeve tona të shumta, jo vetëm si qytetarë, por edhe si zyrtarë.

Ju jeni mbledhur sot këtu në kohën dhe vendin e duhur, pasi Autoriteti ynë i krijuar me ligj, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është në fazën e progresit të tij institucional dhe ligjor, të cilin do ta cilësoja si substancial. Vetëm gjatë vitit të kaluar ky institucion i pavarur ka ndërmarrë procese ligjore të rëndësishme, përmes amendimeve ligjore për ta afruar atë me standardet ndërkombëtare dhe një sërë zhvillimesh institucionale, të cilat i kanë dhënë një shtytës misionit të tij për mbrojtjen e të drejtave. Kuvendi i Shqipërisë, para pak muajsh ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionerit, ku ka vlerësuar zhvillimin institucional të tij në shtimin e kontrolleve dhe masave të tjera të ndërmarra, si dhe për bashkëpunimin me institucione të tjera ligjzbatuese, pa lënë pas dhe ndërgjegjësimin e mëtejshëm të kulturës së ligjit dhe të zbatimit të tij.

Mbrojtja e të dhënave është pjesë e reformave institucionale dhe ligjore që vendi ynë ka ndërmarrë vitet e fundit, reforma që përfshin një sërë angazhimesh të rëndësishme të cilat i raportohen periodikisht Komisionit Evropian. Ashtu sikurse Bashkimit Evropian, përmes institucioneve dhe insistimeve të tij ligjore, detyron shtetet anëtare të garantojnë mbrojtjen e jetës private dhe të dhënave sensitive të qytetarëve, po kështu dhe çdo vend tjetër në hapësirën evropiane, duhet të demonstrojë angazhimin serioz në zbatimin e të njëjtave standarde dhe rregullave të lojës në terren. Dëshiroj të theksoj se ne duhet të bëjmë të mundur në secilin prej vendeve tona, që subjektet e “data-protection” të jenë të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre dhe nga ana tjetër edhe kontrolluesit që procesojnë të dhënat e subjekteve të jenë të ndërgjegjshëm për rolin dhe përgjegjësitë e tyre.

Kuvendi i Shqipërisë do të vijojë të mbështesë punën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me qëllim rritjen e kulturës së mbrojtjes së të dhënave personale, duke ofruar më shumë kapacitete, buxhete të mjaftueshme dhe pavarësinë e duhur në hierarkinë e institucioneve të pavarura.

Tashmë, në pesëvjeçarin e dytë të krijimit të tij, i pajisur me një sërë kompetencash ligjore të shtuara sëfundmi, e konsiderojmë institucionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si një institucion të maturuar për të avancuar në mënyrë të prekshme në fushën e të drejtës personale.

Risqet që sjellin axhendat e ndryshme dixhitale dhe progresi i teknologjive të reja, si të informacionit online dhe medias, por edhe në sektorë të tjerë të zhvillimit shtetëror, si në atë financiar apo të tregjeve e të shkëmbimit të informacionit bankar, ngrenë shqetësimin serioz për nevojën e platformave të përbashkëta për të siguruar që kjo e drejtë themelore kushtetuese e qytetarëve tanë të mos çënohet.

Kuvendi inkurajon orientimin e funksionimit të këtij institucioni drejt harmonizimit të plotë me standardet dhe kuadrin ligjor evropian dhe konsolidimin e parametrave të nevojshëm ligjor që kërkon stadi aktual i zhvillimit të këtyre risqeve në fushën e së drejtës së të dhënave personale.

Çdo diskutim që do të zhvillohet sot në këtë forum duhet përkthyer në masa të mëtejshme ligjore për t'u ndërmarrë, për vetë rëndësinë që ka në kontinentin tonë kjo fushë e të drejtave të njeriut dhe fokusi i veçantë që ka në axhendën Evropiane të Shqipërisë.

Uroj që ky forum të arrijë objektivat që ka parapërcaktuar duke shpresuar se ky shkëmbim eksperiencash do të ndikojë në forcimin e bashkëpunimit mes autoriteteve tuaja në funksion të ngritjes së nivelit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në secilin prej vendeve tona.

Duke shprehur vlerësimin për punën e deritanishme të Komisionerit Dervishi në vendin tonë, dhe duke ju përgëzuar për këtë takim, ju uroj punime të mbara dhe qëndrim të këndshëm në Shqipëri.